



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHE

Data 13.10.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Naftë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Naftë - Kodi- 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.666.666 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e gjashë) lek pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor N.SH.M.A.C Bashkia Korçë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

±

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Përtatimin mbi të ardhurat”, indryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formëselektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.1 Leje për ushtrim aktiviteti 24 ore për të paktën një stacion shitjeje me pakicë të lëndës djegëse karburante brenda Bashkisë Korçë shoqëruar me Autorizimin për hyrje dalje në rrugë për këtë stacion shitjeje.

Leja për ushtrim aktiviteti 24 ore duhet të jetë lëshuar nga Bashkia Korçë.

Autorizimi për hyrje dalje në rrugë duhet të jetë lëshuar nga Bashkia Korçë, ndërsa në rastet kur stacioni ndodhet në rrugë nacionale autorizimi për hyrje dalje duhet të jetë i lëshuar nga Enti Regullator i Rrugëve.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteri i mesiperm u vendos duke patur parasysh percaktimin e bere ne specifikimet teknike qe "Furnizimi i mjeteve te transportit do te behet sipas sipas kerkesave te institucionit, ne cdo ore te dites a te nates,gjate gjitha javes",per kete arsye eshte e nevojshme leja per ushtrim aktiviteti 24 ore.

Autorizimi per hyrje dalje eshte i nevojshem per arsye se eshte nje dokument qe eshte i domosdoshem per ushtrimin e aktivitetit te shitjes te karburantit ."

2.3.2 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar përgjatë vitit fundit nga data e zhvillimit të procedurës .

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

Kriteri i mesiperm u vendos me qellim qe te vertetohet se nafta qe operatori tregeton eshte konform standartit te kerkuar ne specifikimet teknike."

2.2.3 Ofertuesi te disponoje nje autobot ne pronesi ose me qera per te cilin duhet te paraqese,certifikaten e pronesise te mjetit, lejen e qarkullimit , Siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

a) Ne rast se eshte marre me qera te paraqese kontraten e qera-marrjes, te shoqeruar me certifikaten e pronesise te mjetit, lejen e qarkullimit te qiradhenesit,siguracionin e mjetit, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Kriteri i mesiperm u vendos bazuar ne77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" .*

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Ofertuesi duhet te paraqese deklarate se ofron sherbimin nepermjet kartes elektronike ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

Argumentimi: *: Ky kriter është vendosur bazuar ne VKM Nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për cdo mjet që do të furnizohet.*
